



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 25550/22
Kaçanik, 27.09.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **VII (shtatë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27 shtator 2022 (e martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 10:30.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK. Në mbledhje mungoj me arsye, Arben Thaqi- OJQ.

Nga Ekzekutivi i komunës në takim nuk mori pjesë ndokush, edhe pse ishin të ftuar.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

z.Ekrem Livoreka, Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VII-të (shtatë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2022, data 27 shtator, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Gjendja e bizneseve në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka, A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverballi ?

Procesverballi i mbledhjes se VI-të (gjashtë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2022, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverballin e mbledhjes se VI-të (gjashtë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2022, të datës 21.06.2022 / Lënda : 01Nr. 60/01-16807/22.

2. Gjendja e bizneseve në komunën e Kaçanikut;

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: Lidhur me këtë pikë nga Ekzekutivi nuk merr pjesë askush me na dhënë sqarime të nevojshme, sidoqoftë e hapi diskutimin për këtë pikë:

z. Betim Shala: Gjendja e bizneseve në komunën e Kaçanikut është e vështirë sidomos e bizneseve të vogla dhe atyre të mesme, se nuk kanë ndihmë as nga komuna e as nga qeveria.

znj.Arta Avdiu: Që nga koha e pandemisë, gjendja e bizneseve ka ardhur dita ditës duke u vështirësuar. A ka pasur ndonjë ndihmë nga komuna dhe a ka statistika sesa biznese janë shuar ?

z. Ekrem Livoreka: Unë kam pasur takime me disa nga bizneset, probleme kanë sidomos bizneset e vogla dhe të mesme, të rinjtë dita ditës po ikin jashtë vendit. Bizneset e mëdha i ka subvencionuar qeveria gjatë periudhës së Covid-19, ndërkaq në gjendje me të rëndë janë bizneset e vogla.

znj. Arta Avdiu: Edhe bizneset e mesme i ka subvencionuar qeveria, ndërkaq në gjendje më të rëndë janë bizneset e vogla, të cilat nuk i ka subvencionuar as komuna e as qeveria.

znj. Lejla Muhaxheri –Çaka: Është shumë vështirë me funksionuar sidomos bizneset e vogla të cilat nuk janë subvencionuar nga askush, sepse edhe qiraja është shumë e lartë. Për me mbijetuar bizneset e vogla, duhet ndihmohen nga qeveria.

z. Ekrem Livoreka: Në bazë të kontakteve që kam pasur me bizneset, ankesa kanë për numrin e punëtorëve, kriza ekonomike ka kapluar jo vetëm vendin tonë, por është globale. Diskutime tjera nuk ka, kalojmë në pikën vijuese:

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 11:07.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Malsiu



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka